




GRANTI I PERFORMANCËS
GRANT UÇINKA
PERFORMANCE GRANT



VLERËSIMI I TREGUESVE TË GRANTIT TË PERFORMANCËS

KOMUNA E SUHAREKËS



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosova

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHFETIT LOKAL
MINISTRASIVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra


**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Kushtet Minimale

Komuna e Suharekës nuk është kualifikuar për grantin e performancës për vitin 2019.

Kushti i parë minimal (opinionit i auditimit së paku i pamodifikuar me theksim të çështjes) nuk është përmbushur. Opinioni i auditimit të rregullsisë për vitin 2017 është opinion i kualifikuar me theksim të çështjes.

Komuna ka shpenzuar **84.90%** të buxhetit për investim kapitale në vitin 2017, përdërisa në vitin 2016 shkalla e shpenzimeve për këtë kategori ka qenë **79.10%**.



Performanca e Përgjithshme

Performanca e vitit 2016


Performanca e Komunës së Suharekës në 19 treguesit e vlerësuar është 31 pikë nga gjithësej 62 pikë të mundshme (**50%**).

Performanca mesatare e të gjitha komunave është **43.08%**.

Performanca e vitit 2017

Performanca e Komunës së Suharekës në 24 treguesit e vlerësuar është 36 pikë nga gjithësej 90 pikë të mundshme (**40%**).

Performanca mesatare e të gjitha komunave është **45.50%**.



Fusha I – Qeverisja Demokratike

Viti 2016

15 pikë nga gjithsej 32 pikë të mundshme në këtë fushë **(46.88%)**.

Kjo fushë përfshinë tri nënfusha:

- Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikqyrës 73.33%
 - 4 tregues
- Pjesëmarrja dhe konsultimi i qytetarëve 40%
 - 3 tregues
- Gjithëpërfshirja 0%
 - 2 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **45.64%**.


Viti 2017

12 pikë nga gjithsej 37 pikë të mundshme në këtë fushë **(32.43%)**.

Kjo fushë përfshinë tri nënfusha:

- Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikqyrës 40%
 - 5 tregues
- Pjesëmarrja dhe konsultimi i qytetarëve 40%
 - 3 tregues
- Gjithëpërfshirja 0%
 - 2 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **40.60%**.



Fusha II – Menaxhimi Komunal

Viti 2016

7 pikë nga gjithsej 17 pikë të mundshme në këtë fushë **(41.18%)**.

Kjo fushë përfshinë tri nënfusha:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore **42.86 %**
 - 3 tregues
- Menaxhimi i financave dhe auditimi **0%**
 - 1 tregues
- Ofrimi i shërbimeve **100%**
 - 1 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **42.62%**.


Viti 2017

15 pikë nga gjithsej 40 pikë të mundshme në këtë fushë **(37.50%)**.

Kjo fushë përfshinë tri nënfusha:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore **20%**
 - 4 tregues
- Menaxhimi i financave dhe auditimi **15%**
 - 5 tregues
- Ofrimi i shërbimeve **100%**
 - 3 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **44.50%**.



Fusha III – Transparenca dhe Integriteti

Viti 2016

9 pikë nga gjithsej 13 pikë të mundshme në këtë fushë **(69.23%)**.

Kjo fushë përfshinë dy nënfusha:

- **Çasja në informata 100%**
 - 1 tregues
- **Integriteti 60%**
 - 2 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **46.76%**.


Viti 2017

9 pikë nga gjithsej 13 pikë të mundshme në këtë fushë **(69.23%)**.

Kjo fushë përfshinë dy nënfusha:

- **Çasja në informata 100 %**
 - 1 tregues
- **Integriteti 60%**
 - 2 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **63.10%**.



Qeverisja Demokratike (Treguesit e performancës: 1-10)

Komuna e Suharekës në fushën e Qeverisjes Demokratike ka treguar performancë të dobët në treguesit:

Treguesi 1 - Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal nga Kuvendi Komunal / 0 nga 3

Treguesi 3 - Diskutimi i raportit të performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak / 0 nga 4

Treguesi 5 - Diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve (përfshirë edhe planin e veprimit) si të auditorit të brendshëm ashtu edhe të auditorit të jashtëm (ZKA) në mbledhjet e Kuvendit Komunal / 0 nga 5

Treguesi 7 - Aktet e miratuara në Kuvendin Komunal për të cilat është konsultuar publiku / 0 nga 6

Treguesi 8 - Niveli i grave pjesëmarrëse në takime publike / 0 nga 4

Treguesi 9 - Niveli i grave të emëruara në pozita politike / 1 nga 3

Krahasuar me vitin 2016, performanca në fushën e qeverisjes demokratike ka qenë më e ulët për 14.44%.

Menaxhimi Komunal (Treguesit e performancës: 11 -22)

Komuna e Suharekës në fushën e Menaxhimit Komunal ka treguar performancë të dobët në treguesit

Treguesi 11 - Zbatimi i skemës në shpërndarjen e vlerësimeve të punës për shërbyesit civil / 1 nga 3

Treguesi 12 - Zbatimi i skemës në shpërndarjen e vlerësimeve të punës për shërbyesit civil / 1 nga 3

Treguesi 13 - Prezantimi për diskutim në kuvendin komunal i raportit vjetor të zyrës së personelit të komunës për vitin paraprak / 0 nga 2

Treguesi 14 - Shfrytëzimi i Marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV) në pajtim me legjislacionin / 0 nga 3

Treguesi 15 - Disiplina financiare në pagesa (pagesat e ekzekutuara brenda afatit ligjor) / 1 nga 3

Treguesi 16 - Zbatimi i planit të prokurimit (aktivitetet e kontraktuara kundrejt atyre të planifikuara) / 1 nga 3

Treguesi 17 - Përditësimi i regjistrit të tatimit në pronë (ri-anketimi i objekteve sipas legjislacionit / 0 nga 3

Treguesi 18 - Niveli i vjeljes së tatimit në pronë (tatimet e paguara kundrejt shumëve të faturuar) / 1 nga 5

Treguesi 19 - Adresimi i rekomandimeve me prioritet të lartë dhe të mesëm të auditorit të jashtëm (ZKA) / 0 nga 6

Krahasimi i performancës për vitet 2016 dhe 2017 nuk është i mundur për shkak të numrit të madh të treguesve të ngrirë në vitin 2016.

Transparenca dhe Integriteti (Treguesit e performancës: 23-27)

Komuna e Suharekës në fushën e Transparencës dhe Integritetit ka treguar performancë të dobët në treguesin:

Treguesi 26 - Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit në Kuvend Komunal / 0 nga 4

Krahasuar me vitin 2016, performanca në fushën e transparencës dhe integritetit ka qenë e njëjtë.